

Tiranë, më 29 Dhjetor 2020

## NJOFTIM PËR SHTYP

Prezantimi i shkëmbimit mësimor në sistemet e AFP-së në Ballkanin Perëndimor, ka marrë një pozicion të spikatur dhe gjithnjë e në rritje në agjendën e Procesit të Berlinit. Megjithatë, në mënyrë që shkëmbimet të jenë pjesë e realitetit, duhet prezantuar “kultura e shkëmbimeve mësimore” që Evropa ka njohur që nga lancimi i programit Erasmus në vitet 80’. Shihet veçanërisht një nevojë për të informuar mësuesit dhe drejtuesit e shkollave të AFP-së mbi këtë temë, dhe për të rritur kompetencat e tyre në planifikimin dhe menaxhimin e projekteve të shkëmbimit. Gjithashtu në Ballkanin Perëndimor kërkohet më tepër mësim i mbështetur te puna, në mënyrë që të përgatisë të rinjtë për tranzicionin drejt tregut të punës dhe në të njëjtën kohë të mbështesë zhvillimin e ekonomive lokale. ***Qëllimi i përgjithshëm i projektit INTERVET WB është të përmirësojë cilësinë e dispozitave të AFP-së në Ballkanin Perëndimor, që në fund të favorizojë punësimin e të rinjve.*** Projekti “Ndërkombëtarizimi i sistemeve të AFP-së në Ballkanin Perëndimor” (INTERVET WB), financuar nga Bashkimi Evropian dhe udhëhequr nga UNISER, sjell sëbashku 14 organizata të përfshira në AFP, nga 14 vende (midis të cilëve edhe 6 vendet e Ballkanit) për të prezantuar një skemë të kuptueshme shkëmbimi në vendet e zgjeruara.

Në Shqipëri, projekti synon të krijojë mundësi shkëmbimi mësimor për ofruesit e AFP-së dhe të përmirësojë kulturën e shkëmbimeve mësimore në fushën e AFP-së, *përmes 82 shkëmbimeve afatshkurtra (1 mujore) dhe afatgjata (3 mujore) për studentët dhe mësuesit e AFP-së; 9 eksperiencë njëjavore Job Shadowing për mësuesit e AFP-së në Shqipëri drejt vendeve partnere ofruese Evropiane; 6 Shkëmbime të mësuesve të AFP-së nga Shqipëria për të marrë pjesë në Shkollat Verore mbi shkëmbimet dhe të mësuarit bazuar në punë; 12 mësues nga Shqipëria për të marrë pjesë në Ekipet Tematike në partnerët ofrues Evropian të AFP-së.*

Përgjatë vitit të parë të implementimit të INTERVET WB, të gjithë të interesuarit u prezantuan dhe u informuan mbi projektin dhe progresin e bërë në aktivitete të caktuara, si edhe mbi shkëmbimet e ardhshme për të ndërtuar kapacitetin e stafit akademik dhe shkëmbimit mësimor të studentëve. *[Për 2020](#), ne kemi arritur të kompletojmë 1 Event Ekipi Teamatik, 3 Shkëmbime në Shkollë Verore dhe 2 Takime Transnacionale pavarësisht kufizimeve botërore prej pandemisë. Gjithashtu kemi përmbyllur procesin e përzgjedhjes së 10 studenteve të AFP-së për Shkëmbime Afatshkurtra (1 mujore, në Itali) dhe përzgjedhjen e 3 mësuesve të AFP-së për Shkëmbime Job Shadowing (në Holandë). Të dyja këto shkëmbime do të realizohen në 2021. Për më tepër, gjatë 2021, do të ketë thirrje të tjera në aktivitetet përkatëse si Job Shadowing, Shkollë Verore dhe Shkëmbim Mësimor. Datat tentativë janë në tre muajt e parë të 2021, por ende të paparashikuara për shkak të kufizimeve të COVID-19.*

Në rrjedhën e implementimit të projektit, shpërndarja e informacionit, aplikimi dhe procesi i përzgjedhjes për shkëmbime, i janë komunikuar vazhdimisht Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), Drejtorive të Përgjithshme të Punësimit dhe Qendrave të Trajnimit Profesional (DRP & QFP), Shkollave Profesionale dhe studentëve, me suportin e drejtuesve të shkollave dhe stafit

të tyre, si edhe në komunikim të afërt me ta. Për sa i përket procesit të përzgjedhjes, gjeni këtu listën e mësuesve të AFP-së të zgjedhur nga 34 aplikime për Job Shadowing në Holandë. Për më tepër, nga 35 aplikime nga studentët e AFP-së për shkëmbimin mësimor në Itali gjeni këtu listën e studentëve të përzgjedhur. Një prej mësuesve që morën pjesë në Shkollën Verore, thekson se përpos faktit që njohu kolegë nga e gjithë bota, me të cilët shkëmbeu eksperiencë. Gjithashtu, ajo mësoi më tepër seç priste mbi anën praktike të punës në grup dhe të mësuarit praktik në shkollë. Ky është pikërisht një qëllim i skemave të shkëmbimit në vetvete. Nga ana tjetër, studentët janë gjithashtu shumë të gëzuar që do të ndjekin shkëmbimin një muaj në Itali. Një prej tyre, gjatë xhirimit të një videoje për intervistën theksoi se ëndrra e tij për të patur një eksperiencë të tillë, për të qenë në kontakt me kulturën e edukimit, punës dhe çështjeve sociale të Evropës, do të bëhet realitet së shpejti me INTERVET WB.

Në [Konferencën e Ndërkombëtarizimit të AFP-së](#), organizuar nga Komisioni Evropian dhe Fondacioni i Trajnimit Evropian në kuadër të Eventeve të Javës së Aftësive Evropiane 2020, u organizua në 9-13 Nëntor në Berlin, dhe [Ceremonia e Ndarjes së Cmimeve për Ekselencën AFP si edhe Ceremonia e Mbylljes](#), Albanian Skills ekspozoi aplikimin praktik të ndërkombëtarizimit të arsimit profesional në Shqipëri përmes përfshirjes së sektorit privat dhe projektit të shkëmbimeve INTERVET. Për Albanian Skills, aftësitë teknike kanë rëndësi dhe jo diplomat, ndërkohë aftësitë nuk kanë kombësi. Konkurset e aftësive në Shqipëri dhe projektin INTERVET Western Balkans shihen si mënyra të shkëlqyera dhe të nevojshme për zhvillim dhe përshtatjen me aftësitë që duhen ndërkombëtarisht.

*Për informacion të mëtejshëm, ju lutem kontaktoni:*

Ana ZACHARIAN  
Drejtoreshë Ekzekutive e Albanian Skills  
Email: [albanianskills@gmail.com](mailto:albanianskills@gmail.com)  
Website i Albanian Skills: [albanianskills.org](http://albanianskills.org)  
Tel: +355692147725

Annalisa PALANO  
Kordinatore Projekti UNISER  
E-mail: [annalisa@uniser.net](mailto:annalisa@uniser.net)  
Website i Intervet Western Balkans: [intervetwb.net](http://intervetwb.net)